VENDIM
Nr.35, datë 19.1.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.787, DATË 14.12.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE DHE TË MASËS SË NDIHMËS EKONOMIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 19 pika 3, 20 pika 2, 29, pika 10 e 35 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 23/1 e kreut III të vendimit nr.787, datë 14.12.2005 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"23/1. Përfitimi i ndihmës ekonomike, në masën e përcaktuar në pikat 18, 19, 20, 21 dhe 22, të këtij vendimi, paguhet nga shërbimet bankare ose Posta Shqiptare, pranë njësive të qeverisjes vendore ku ka vendbanimin përfituesi.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha